

Për: Komisioni i Pavarur për Media ("KPM")

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

Nga: IPKO Telecommunications LLC

Lënda: Komentet e IPKO Telecommunications mbi projekt Rregulloren për Vlerësimin e Aplikacioneve për Licencë të KPM's

Data: 30 prill 2013

Të nderuar anëtarë të KPM-së,

Ju lutem gjeni më poshtë komentet e IPKO-s mbi projekt Rregulloren për Vlerësimin e Aplikacioneve për Licencë të KPM's.

IPKO shpreh gatishmërinë për tu takuar në mënyrë individuale për të diskutuar komentet e dhëna në këtë dokument. Për më tepër, ne presim nga KPM të ndajë me të gjithë palët e interesuara komentet e ofruara nga të gjithë prej tyre dhe të organizojë dëgjim publik para miratimit të versionit përfundimtar të së njëjtës.

Komentet mbi nenet përkatëse

Neni 3- Përkufizimet:

- Duhet të specifikohet qartë që procesi i konkursit përkatësisht aplikimit, nuk është i aplikueshëm për televizionet kabllore, përkatësisht të njëjtit nuk kanë nevojë të presin për konkurs të hapur nga KPM për licencim.
- Duhet të specifikohet qartë rrethanat e shpalljes së konkursit, në çfarë periudha kohore do të hapet ky konkurs, koha sa do të jetë i hapur si dhe detajet e tjera të këtij procesi.

Neni 4- Procesi i Vlerësimit:

4.2 “Dokumentacioni i konkursit dorëzohet në zarf të mbyllur (2 kopje). Zarfi do të hapet para komisionit përkatës të KPM-së, pas përmbarimit të afatit të konkursit, për të cilin aplikuesit do të njoftohen përmes mediave elektronike dhe të shkruara”

KPM duhet të njoftoj direkt aplikuesit, krahas njoftimeve të bëra nëpërmjet mediave elektronike apo të shkruara.

Neni 8- Vendimet e Komisionit:

*Vendimet e Komisionit të KPM-së lidhur me vlerësimin e aplikacioneve, do të bëhen publike sipas nenit 23 paragrafi **3 dhe 4** të Ligjit të KPM-së.*

Për më shumë informata rreth komenteve të paraqitura në këtë dokument, ju lutem të mos hezitoni të na kontaktoni.